



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:002415

Datë: 10.01.2022

Numri i dokumentit: 02587919

Ac.nr.10353/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Kujtim Pasuli-kryetar i kolegjit, Nenad Llaziq e Makifete Saliuka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit S. G. nga Prishtina, i përfaqësuar sipas autorizimit av. Sh. H., nga Prishtina, kundër kundërshtarit të sigurimit V. G. nga Prishtina, i përfaqësuar sipas autorizimit av. F. K., nga Prishtina, duke vendosur sipas ankesës të kundërshtarit të sigurimit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.45/21 të datës 26.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet ankesa e kundërshtarit të sigurimit V. G. nga Prishtina, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.45/21 të datës 26.11.2021, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e goditur nën I të dispozitivit është aprovuar i bazuar propozimi i propozuesit S. G. nga Prishtina, caktohet masa e sigurimit, ashtu që i ndalohet kundërshtarit të sigurimit V. G. nga Prishtina, të ndërmerr ndonjë veprim me qëllim të ndryshimit të gjendjes ekzistuese faktike, shitjes, bartjes në persona të tretë, ngarkimit me ndonjë të drejtë sendore ose detyrimore apo ndryshimi i gjendjes faktike dhe i ndalohet veprimtaria, në lokalin afarist nr. 56, i cili gjendet në rr. “....” në Prishtinë, në ngastrën Kadastrale nr. 07350-1, Zona Kadastrale Prishtinë, deri në përfundim të kësaj procedure kontestimore, apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate. Nën II të dispozitivit detyrohet Zyra Kadastrale në Komunën e Prishtinës, dhe Oda e Noterëve, që ndalimin nga dispozitivi i parë (I) i këtij aktvendimi, ta evidentojnë në regjistrat përkatës të tyre. Nën III të dispozitivit ky aktvendim, menjëherë do t’u dërgohet palëve ndërgjyqës, Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prishtinës dhe Odës së Noterëve të Kosovës.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i kundërshtarit të sigurimit av. F. K. , për shkak të:

-Shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së dhe
-Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë të aprovon ankesën si të bazuar, ashtu që aktvendimin e goditur ta ndryshoj dhe ta refuzoj si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë ose ta prish dhe lëndën ta kthejë gjykatës së shkallës së parë në procedurë.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194, e lidhur me nenin 208 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka vlerësuar aktvendimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, dhe gjeti se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkrerat e lëndës rezulton se paditësi – propozuesi nëpërmjet të autorizuarit av. Sh. H. nga Prishtina, ka parashtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, ashtu që ka kërkuar që të vërtetohet se është pronar i lokalit nr. 56 i cili gjendet në rrugën “...”, bazuar në kontratën për shitblerje të dt. 15.12.1998 dhe të detyrohet drejtoria për kadastrë dhe pronë që të bëjë regjistrimin në librat Kadastrale të këtij lokali në emër të paditësit. Njëherit ka propozuar që gjykata të cakton masën e sigurimit ndaj këtu të paditurit – kundërshtarit të sigurimit V. G., ashtu që të njëjtit ti ndalohet të ndërmerr ndonjë veprim me qëllim të ndryshimit të gjendjes ekzistuese faktike, shitjes, bartjes në personat të tretë ngarkimit me ndonjë të drejtë sendore ose detyrimore apo ndryshimi i gjendjes faktike dhe i ndalohet veprimtaria në lokalin afarist nr. 56 i cili gjenet në rrugën “...” në Prishtinë, në ngastrën Kadastrale nr. 07350-1 Zona Kadastrale Prishtinë, deri në përfundim të kësaj procedure kontestimore apo deri në një vendim tjetër të kësaj gjykate.

Gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendimin të përshkruar si në dispozitivit të aktvendimit të goditur, duke gjetur se propozimi i propozuesve për caktimin e masës së sigurimit në rrethanat aktuale është i bazuar. Kjo për faktin se me dispozitën e nenit 297 të LPK-së, është paraparë se masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Kurse me nenin 304.3 të LPK-së, është përcaktuar mes tjerash se propozuesi në propozimin e tij duhet ti tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim si dhe që këto mjete provuese t’ia bashkëngjit propozimit. Gjykata e shkallës së parë nga e gjithë kjo ka vlerësuar se propozuesi e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive ngase kishte pretendimin që ai kishte të drejtën e pronësisë në lokalin afarist nr. 56 – kontestuese dhe se pretendimi që kishte blerë këtë lokal dëshmohej nga kontrata e shitblerjes e dt. 15.12.1998, vërtetimit – dëftesës mbi dorëzimin e të hollave N. B. e të cilat ky nuk i ka kundërshtuar me përgjigje në padi të paraqitur me dt. 27.01.2021, si dhe fatura e tatimit në pronë e dt. 25.01.2021 në emër të propozuesit. Njëherit gjykata e shkallës së parë ka gjetur se në

gjendjen e tanishme vërehet rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë kundër propozuesi do të mund të ndërmerre veprime juridike të cilat do të mund të pamundësonin apo vështirësonin realizimin e kërkesës duke ndryshuar gjendjen faktike, të bëhet tjetërsimi i lokalit, duke ngarkuar të njëjtin, apo duke e shitur pasi e ka në posedim dhe shfrytëzim faktik të lokalit. Prandaj duke marr për bazë deklaratat e palëve ndërgjyqës, provat e prezantuara, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se propozuesi ka arritur të bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij në kuptim të nenit 297 par. 1 pika a) si dhe nga ana tjetër ka bërë të besueshme edhe rreziku se pa caktimin e masës do të mund të ndryshojë gjendja juridike e pronësisë së paluajtshmërisë kontestuese ngase lokali afarist për të cilën është kërkuar të vendoset masa e sigurisë nga data 01.01.2018 e deri më tani e ka në shfrytëzim dhe posedim kundër propozuesi dhe se i njëjti do të mund të ndërmerre veprime juridike të cilat do të mund të pamundësonin apo do të vështirësonin realizimin e kërkesës duke ndryshuar gjendjen faktike, të bëhet tjetërsimi i lokalit, duke ngarkuar të njëjtën apo duke e shitur, pra me ndonjë veprim në këtë fazë të procedurës do të mund të shkaktohej ndonjë dëm i madh për propozuesin. Vendimin e vet e mbështet në dispozitën e nenit 297 .1 pika a) dhe b), nenit 300 par. 1 pika a) dhe c) dhe nenit 387 .1 pika i) lidhur me nenin 142 .5 të LPK-së.

Gjykata e Apelit pranë gjendjes së këtyre të çështjes dhe duke vlerësuar ankesën e paditurës kundër propozuesit, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë aktvendimin e goditur ka marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat me të drejtë tregon ankesa nga neni 182 par.1 e lidhur me nenin 362.1 si dhe me nenin 182 par. 2 pika n) të LPK-së. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar drejtë dispozitat e lartcekura, kurse kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e aktvendimit të drejtë e të ligjshëm.

Kjo gjykatë pranon pretendimin ankimor të paditurës se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur parasysh dispozitën e nenit 362.1 të LPK, e cila dispozitë parasheh që përpos detyrimit të dorëzimit të ekspertizës me shkrim, është gjithashtu detyrim që gjykata ta thërret ekspertin në seancë për shqyrtim kryesor të çështjes, nga se kjo mundëson gjykatës dhe palëve duke parashtruar pyetje ekspertit të kërkojnë sqarim, përmirësim e të tjera, e që është në pajtim me parimin e drejtshmërisë dhe oralitetit. Kjo për faktin se gjykata apriori nuk mund të prejudiojë se cili është mendimi dhe qëndrimi i palëve ndaj mendimit dhe konstatimit të ekspertit, sepse e paditura në seancë ka kundërshtuar ekspertizën e ekspertit gjeodet, duke theksuar se nuk dihet kush është pronar dhe një sqarim është i domosdoshëm. Pra, për arsye të lartcekura eksperti gjithmonë ftohet për në seancën në shqyrtimin, prandaj duke qenë se gjykata e shkallës së parë nuk ka thirrur ekspertin dhe e paditura – kundër propozuesi këtë edhe potencon në ankesë, atëherë gjykata e shkallës së parë me këtë lëshim ka bërë shkeljen thelbësore të dispozitave të LPK, për të cilat arsye aktvendimi i goditur detyrimisht u deshtë të priset dhe të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, sepse kjo dispozitë e lartcekur në mënyrë analoge zbatohet edhe për seancën lidhur me masën e sigurisë. Njëherit edhe dispozitivi është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin, ngase në të nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare për marrjen e një vendimi të tillë. Kjo posaçërisht konsiston në faktin se për gjykatën e apelit është e paqartë çka ka motivuar gjykatën e shkallës së parë që të cakton masën e sigurimit që i referohet shitjes, bartjes në persona të tretë, ngarkim me ndonjë të drejtë sendore ose detyimore dhe ti ndalohet veprimtaria në lokalit kontestues, ndaj të paditurit – kundër propozuesit V. G. nga Prishtina, pasi që i njëjti me asnjë provë nuk figuron si pronar i këtij lokalit kontestues, por pronar është shkolla fillore “Faik Konica” Prishtinë dhe për këtë arsye edhe vihet në pikëpyetje arsyeshmëria e caktimit të këtyre masave, e për arsye të cekur si më lart, duke qenë se i njëjti nuk është pronar dhe ligjërisht nuk mund të shet, bart tek personat e tretë, të ngarkoj me ndonjë të drejtë sendore ose detyimore. Gjithashtu në mungesë të arsyeve të mjaftuara për kontratën e shitblerjes që është në shkrerat e lëndës në mes të këtu paditësi dhe N. B., nga i cili paditësi

pretendon se ka blerë lokal, atëherë kjo gjykatë detyrimisht u dashtë që ta prish dhe aktvendimin e goditur ta kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë duhet të ftoj ekspertin gjeodet në seancë, ashtu që të deklarohet për ekspertizën e vet dhe për pyetjet që do të parashtrihen eventualisht nga palët ndërgjyqës si dhe të vlerësoj arsyeshmërinë e caktimit të masës së sigurisë të propozuar nga paditësi – propozuesi në raport me të paditurin V. G., ashtu siç obligon neni 297 par. 1 pika a) dhe b) , gjë që në fund duhet të rezultojë me një vendim të drejtë e të ligjshëm.

Nga të paraqiturat si dhe nga arsyet e cekura në aktvendimin e goditur e në kuptim të nenit 209 par. 1 pika d) të LPK-së, është vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10353/21 të datës 30.12.2021

Kryetar i kolegjit – gjyqtari
Kujtim Pasuli